

## Vendim nr. 282 datë 25.11.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, në datën 25.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **MIGENA REÇI**, përfaqësuar nga avokate Eda Grimçi, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3600 (299), datë 21.09.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 41, 42, 124 e vijues, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Migena Reçi ka qenë me detyrën e drejtoreshës së përgjithshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Artit, Rinisë dhe Sportit, në Ministrinë e Kulturës (*MK*). Me shkresën nr. 5233 prot., datë 25.10.2013 të sekretarit të përgjithshëm të MK-së, drejtuar Departamentit të Administratës Publike (*DAP*), është propozuar kalimi i kërkeses në listëpritje,

në zbatim të urdhrit nr.185, datë 18.10.2013 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturës”. Në vijim, me shkresën nr. 6310 prot., datë 19.12.2013 të DAP-it është miratuar kalimi i kërkueses në listëpritje, në kuadër të ristrukturimit, në pamundësi të ofrimit të një pozicioni të të njëjtit nivel ose një nivel më poshtë. Me shkresën nr. 21 prot., datë 07.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm të MK-së është vendosur kalimi i kërkueses në listëpritje dhe njëherësh edhe njoftimi lidhur me këtë fakt.

2. Duke mos qenë dakord me kalimin në listëpritje, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5579, datë 13.10.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të veprimit administrativ të pasqyruar në shkresën nr. 21, datë 07.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm të MK-së; detyruar palën e paditur, MK-në, për të kthyer kërkuesen në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të një niveli më të ulët, si dhe për t’i paguar asaj pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në punë; rrëzuar padinë për pjesën tjetër të kërtimeve. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuesja dhe pala e paditur, MK-ja.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3092, datë 06.10.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pranimin e pjesës së padisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 21 prot, datë 07.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm të MK-së për kalimin në listëpritje; rikthyer kërkuesen në Shërbimin Civil në një pozicion pune të barasvlershëm me drejtor të përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave për Artin, Rininë dhe Sportin dhe detyruar palën e paditur t’i paguajë asaj pagën nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ditën e rikthimit në punë; rrëzuar padinë për pjesën tjetër të kërtimeve. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs palët e paditura, MK-ja dhe DAP-i.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3600 (299), datë 21.09.2023, ka ndryshuar vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke vendosur rrëzimin e padisë.

5. Në datën 29.08.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi as kërkuesja dhe as përfaqësuesja e saj nuk janë njoftuar nëpërmjet postës elektronike për datën e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, ndonëse në vijim vendimi i asaj gjykate i është komunikuar përfaqësueses ligjore. Në këtë mënyrë, kërkueses i është mohuar e drejta për të paraqitur parashtrime shtesë përpara datës së zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit.

6.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm nuk është ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ligji nr. 152/2013), por ligji nr. 8549/1999 “Për statusin e nëpunësit civil” (ligj nr. 8549/1999) dhe duke u bazuar në këtë fakt ka vendosur rrëzimin e padisë pa bërë një analizë të rrethanave të faktit dhe ligjit në situatën konkrete. Ajo gjykatë nuk ka bërë veshjen e duhur ligjore të rrethanave të faktit dhe, për rrjedhojë, çështja nuk është zgjidhur në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale të zbatueshme. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka marrë atributet e një gjykate fakti.

6.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi ndaj kërkueses është zbatuar një ligj i shfuqizuar. Në rastin në shqyrtim gjykatat duhet të zbatonin ligjin nr. 152/2013, i cili i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi më 01.10.2013, për sa kohë për këtë çështje nuk ka ende një vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe për shkak se shtyrja e hyrjes në fuqi të tij është shfuqizuar me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës (vendimi nr. 5/2014). Edhe nëse ndaj kërkueses zbatohet ligji nr. 8549/1999, Gjykata e Lartë duhet të kishte prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe të linte në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila e ka zgjidhur çështjen po me atë ligj. Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se kërkueses nuk i është ofruar një vend pune i të njëjtit nivel ose niveli më të ulët.

6.1.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse i është referuar nenit 23 të ligjit nr. 8549/1999, në asnjë moment nuk ka marrë parasysh se kërkueses nuk i është ofruar një vend pune i të njëjtit nivel ose niveli më të ulët dhe as faktin se akti i sekretarit të përgjithshëm për kalimin në listëpritje është

absolutisht i pavlefshëm. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është rrjedhojë e logjikës juridike, pasi megjithëse ajo gjykatë ka përcaktuar se ligji i zbatueshëm është ai nr. 8549/1999, sikundër është shprehur gjykata e shkallës së parë, në përfundim ka ndryshuar vendimet e gjykatave të faktit, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim paraqitet kontradiktor dhe dispozitivi nuk është rrjedhojë logjike e arsytimit në pjesën përshkruese, si dhe nuk shprehet për arsyen e rrëzimit të kërkesëpadisë. Vendimi për kalimin në listëpritje nuk është në formën e kërkuar nga ligji, pasi ai ka formën e një shkrese njoftimi dhe jo të vendimit.

- 6.2. *Parimin e barazisë përpara ligji*, pasi në çështje analoge, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm është ligji nr. 152/2013.
- 6.3. *Të drejtën për punë*, të sanksionuar në nenin 49 të Kushtetutës, pasi asaj i cenohet e drejta për të qenë e punësuar pranë organit administrativ, si dhe është e detyruar të kthejë vlerën e caktuar si dëmshpërblim.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. *Për legjitimimin e kërkueses*

7. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 21.09.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 29.08.2024. Referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton se kërkesja është njoftuar për vendimin e kundërshtuar në datën 02.05.2024, në adresën elektronike të përfaqësueses së saj, ndaj është kjo datë momenti nga i cili fillon afati ligjor 4-mujor i përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsytimit të vendimit, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe së drejtës për punë.

13. Lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit, kërkesja ka pretenduar se në çështje analoge, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm është ai nr. 152/2013. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur janë ngritur pretendime në lidhje me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr.*

19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Po kështu, rastet e ekzistencës së disa vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për interpretimin e ligjit, Gjykata i ka trajtuar edhe në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, duke u shprehur se ky fakt nuk mund të sjellë prishmëri të ligjshme të kërkuarit për zbatimin e ligjit, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues ose njëses në lidhje me të (shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuarja nuk ka sjellë asnjë argument konkret dhe nuk ka arritur të provojë nga pikëpamja kushtetuese pretendimet e saj në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Kërkuarja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm nuk është ligji nr. 152/2013, por ai nr. 8549/1999 dhe duke u bazuar në këtë fakt ka vendosur rrëzimin e padisë pa bërë një analizë të rrethanave të faktit dhe ligjit në situatën konkrete. Ajo gjykatë nuk ka bërë veshjen e duhur ligjore të rrethanave të faktit dhe, për rrjedhojë, çështja nuk është zgjidhur në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale të zbatueshme. Po kështu, kërkuarja ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, me argumentin se ndaj saj është zbatuar një ligj i shfuqizuar, pasi gjykatat duhej të zbatonin ligjin nr. 152/2013. Sipas saj, edhe nëse do të zbatohet ligji nr. 8549/1999, Gjykata e Lartë duhej të kishte prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe të linte në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila e kishte zgjidhur çështjen po me atë ligj.

16. Mbledhja e Gjyqtarëve, duke u bazuar në përmbajtjen e argumenteve të pretendimeve të ngritura nga kërkuarja, vlerëson t'i analizojë ato në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit. Po kështu, edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për punë, i garantuar në nenin 49 të Kushtetutës, çmon të analizohet në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi, në thelb, lidhet me qëndrimin e mbajtur nga gjykatat e zakonshme për zgjidhjen e çështjes me objekt marrëveshjen e punës.

17. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve në vijim çmon të trajtojë pretendimet e kërkuarjes për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur dhe standardit të arsytimit të vendimit, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*

18. Kërkuesja ka pretenduar se as ajo dhe as përfaqësuesja e saj nuk janë njoftuar nëpërmjet postës elektronike për datën e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, ndonëse në vijim vendimi i asaj gjykate i është komunikuar përfaqësueses ligjore. Në këtë mënyrë, kërkueses i është mohuar e drejta për të paraqitur parashtrime shtesë përpara datës së zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për procesin gjyqësor, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, kjo e drejtë, ndër të tjera, i krijon një pale ndërgjyqëse të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 40, datë 14.09.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur, gjithashtu, se është detyrë e administratës gjyqësore të marrë masat për të kryer njoftimin e palëve ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 41, datë 29.05.2024; nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 32, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se neni 61 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, ka parashikuar se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve, në dhomën e këshillimit (*pika 1*). Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara (*pika 2*). Në shtesë të këtyre rregullave, neni 482, pika 3, i Kodit të Procedurës Civile, i zbatueshëm edhe për gjykimin administrativ, parashikon se njoftimi me shpallje bëhet edhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Krahas njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimin.

21. Në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekruseve të paraqitura nga MK-ja dhe DAP-i. Nga materialet në dosjen gjyqësore të administruar rezulton se kërkuesja ka marrë dijeni për rekursin e DAP-it me dëftesën e komunikimit të datës 30.11.2016 dhe rekursin e MK-së në datën 11.11.2016, por nuk ka paraqitur kundërrekurs. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, konstatohet se në datën 01.08.2023 është publikuar lista e çështjeve që do të gjykoreshin në dhomën e këshillimit të datës 21.09.2023, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses, megjithatë nuk rezulton që kjo datë t'i

jetë komunikuar përfaqësueses së kërkueses nëpërmjet postës elektronike, edhe pse ajo ka lënë të dhënat elektronike të kontaktit.

22. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se Gjykata e Lartë në vendimin objekt kundërshtimi është shprehur se palët kanë marrë njoftim sipas ligjit për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit dhe nuk kanë depozituar qëndrim me shkrim përpara saj, ndaj nuk rezulton që të ketë ndonjë çështje ligjore të panjohur për ato, përkundrazi, çështje të kësaj natyre kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nga ana tjetër, vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë i është komunikuar në rrugë elektronike përfaqësueses së kërkueses.

23. Lidhur me shkeljet procedurale, Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje e bën procesin të parregullt, në aspektin e cenimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në referim të këtyre standardeve, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se mungesa e njoftimit individual nga Gjykata e Lartë për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nuk rezulton të ketë ndikuar në cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur të kërkueses, në kuptimin substancial, për sa kohë që ajo është njoftuar për rekursin, dhe ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs. Po kështu, rezulton se në rekursin e paraqitura nga palët e paditura janë ngritur pretendime në drejtim të zbatimit të ligjit në mosmarrëveshjen objekt gjykimi, të cilat janë debatuar nga palët në gjykatat e faktit. Për më tepër, pretendimet e kërkueses në ankimin kushtetues individual në lidhje me cenimin e këtyre të drejtave janë formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa treguar ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë gjatë procesit gjyqësor, i cili mund të passillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së saj nga Gjykata e Lartë.

25. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit*

26. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë, ndonëse i është referuar nenit 23 të ligjit nr. 8549/1999, në asnjë moment nuk ka marrë parasysh se asaj nuk i është ofruar një vend pune i të njëjtit nivel ose niveli më të ulët dhe as faktin se akti i sekretarit të përgjithshëm për kalimin në listëpritje është një akt absolutisht i pavlefshëm. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është rrjedhojë e logjikës juridike, pasi megjithëse ajo gjykatë ka përcaktuar se ligji i zbatueshëm është ai nr. 8549/1999, sikundër është shprehur gjykata e shkallës së parë, në përfundim ka ndryshuar vendimet e gjykatave të faktit, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë. Ky vendim paraqitet kontradiktor dhe dispozitivi nuk është rrjedhojë logjike e arsytimit në pjesën përshkruese, si dhe nuk shprehet për arsyen e rrëzimit të kërkesëpadsisë. Vendimi për kalimin në listëpritje nuk është në formën e kërkuar nga ligji, pasi ai ka formën e një shkrese njoftimi dhe jo të vendimit. Po kështu, sipas kërkueses, megjithëse gjykatat duhej të zbatonin ligjin nr. 152/2013, edhe në rast se ndaj saj do të zbatohesh ligji nr. 8549/1999, Gjykata e Lartë duhej të kishte prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe të linte në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila e kishte zgjidhur çështjen mbi bazën e këtij të fundit. Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se kërkueses nuk i është ofruar një vend pune i të njëjtit nivel ose niveli më të ulët.

27. Gjykata ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po kështu, Gjykata ka theksuar se zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga

gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Bazuar në standardet e mësipërme dhe thelbin e pretendimeve të kërkuases, Mbledhja e Gjyqtarëve do të analizojë nëse Gjykata e Lartë në vendimin e kundërshtuar i ka dhënë përgjigje kërkuases në lidhje me ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e marrëveshjes objekt gjykimi.

30. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuësja ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi objekt i ankimit kushtetues, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative për kalimin e saj në listëpritje dhe zgjidhjen e pasojave të kësaj pavlefshmërie përmes rikthimit në pozicionin e mëparshëm të punës ose të një kategorie më të ulët dhe pagimit të pagës nga data e kalimit në listëpritje e deri në rikthimin në punë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm është ai nr. 8549/1999 dhe nisur nga fakti se kërkuësja është larguar nga Shërbimi Civil dhe ka dalë në listëpritje për shkak të ristrukturimit të vendit të punës, asaj i lindte e drejta për t'u punësuar në një pozicion të të njëjtit nivel në një ministri ose institucion shtetëror tjetër të administratës publike, ose në pamundësi në një vend të një niveli më të ulët. Kërkuases nuk rezulton që t'i jetë ofruar një pozicion i tillë, ndonëse sipas strukturës së re janë krijuar vende të reja pune. Po kështu, sipas kësaj gjykate, vendimi për kalimin në listëpritje i sekretarit të përgjithshëm nuk është në formën e kërkuar nga ligji, pasi ka formën e një shkrese njoftimi dhe jo të vendimit. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se largimi i kërkuases nga pozicioni i punës është bërë në kundërshtim me ligjin, duke përcaktuar edhe detyrimin për pagimin e pagës deri në rikthimin në detyrë.

31. Në të kundërt të këtij qëndrimi, gjykata e apelit ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm në rastin e kërkuases është ai nr. 152/2013, i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2013. Ndonëse me aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 efektet e ligjit janë shtyrë në kohë edhe për 6 muaj, ky akt normativ është shfuqizuar nga Gjykata me vendimin nr. 5/2014, çka ka sjellë, si pasojë, se efektet e ligjit nr. 152/2013 fillojnë nga momenti i miratimit të tij. Në analizë të kuadrit ligjor, gjykata e apelit ka vlerësuar se ligji nr.152/2013 është i zbatueshëm për rastin objekt shqyrtimi, i cili është pjesë e marrëdhënies së Shërbimit Civil dhe i shtrin efektet e tij nga data 01.10.2013, datë e hyrjes në fuqi të tij, për sa kohë për këtë çështje nuk ka ende një vendim të formës së prerë, për shkak se kjo çështje është në gjykim nga kjo gjykatë, si dhe për pasojë të rrëzimit të shkakut që shtynte efektet ligjore të këtij ligji. Për sa i përket formës së shkresës së sekretarit të përgjithshëm, kjo gjykatë ka çmuar se përbën akt administrativ në kuptim të ligjit nr. 152/2013 dhe ky akt është

absolutisht i pavlefshëm, pasi për kërkuesen lindte e drejta për t'u transferuar në një pozicion tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. Kërkuesja nuk mund të nxirrej në listëpritje, pasi ky koncept nuk njihet nga ligji nr. 152/2013. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka vendosur rikthimin e kërkueses në një pozicion pune të barasvlershëm me pozicionin e saj të mëparshëm dhe pagimin e pagës deri në ditën e rikthimit në detyrë.

32. Gjukata e Lartë ka vendosur ndryshimin e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë. Sipas saj, ligji i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative është ai nr. 8549/1999, përkatësisht neni 23, i cili parashikon largimin nga Shërbimi Civil në rast ristrukturimi. Ndonëse ligji nr. 152/2013 ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2013, efektet e tij janë shtyrë me aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013. Ky i fundit është shfuqizuar nga Gjukata me vendimin nr. 5/2014, ndërsa kërkesëpadia është depozituar në muajin korrik 2014, disa muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.02.2014 të vendimit të Gjukatës. Sipas Gjukatës së Lartë, parashikimi në nenin 76 të ligjit nr. 8577/2000 se vendimet e Gjukatës kanë fuqi prapavepruese ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë, duhet të kuptohet për tërësinë e çështjeve administrative që kanë qenë në shqyrtim, çka nuk është rasti i kërkueses. Po kështu, neni 68 i ligjit nr.152/2013 ka parashikuar se çdo procedurë tjetër në proces, e nisur përpara shtrirjes së efekteve të këtij ligji, do të përfundohej sipas dispozitave të ligjit nr. 8549/1999. Për kërkuesen, procedura e ristrukturimit ka filluar që në datën 25.10.2013 dhe pavarësisht se ka përfunduar në datën 07.01.2014, ligji i zbatueshëm do të jetë ligji nr. 8549/1999. Gjithashtu, veprimi administrativ i sekretarit të përgjithshëm është kryer sipas formës dhe procedurës së parashikuar nga ligji dhe nuk mund të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm. Në këto kushte, Gjukata e Lartë ka konkluduar se padia duhet të rrëzohet.

33. Në rastin e kërkueses, Mbledhja e Gjuktarëve evidenton se ajo i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi në datën 11.07.2014. Në datën 30.05.2013 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 152/2013, i cili parashikonte datën 01.10.2013 si momentin e hyrjes në fuqi dhe, me hyrjen në fuqi të tij, shfuqizohej ligji nr. 8549/1999. Gjatë kohës që pritej hyrja në fuqi e ligjit, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013, me qëllim shtyrjen në kohë të efekteve të ligjit nr. 152/2013, akt i cili është shfuqizuar nga Gjukata me vendimin nr. 5/2014, i cili ka hyrë në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.02.2014. Në këto rrethana, Mbledhja e Gjuktarëve vëren se në momentin që ka hyrë në fuqi ky vendim i Gjukatës çështja e kërkueses nuk ka qenë në shqyrtim përpara gjykatave të zakonshme.

34. Në dritën e këtyre rrethanave, Mbledhja e Gjuktarëve vëren se Gjukata e Lartë ka vepruar brenda funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit të zbatueshëm në

mosmarrëveshjen konkrete, duke arsyetuar se ligji i zbatueshëm, në rastin konkret, është ai nr. 8549/1999. Në këtë drejtim, nisur nga thelbi dhe përmbajtja e pretendimit të kërkueses, rezulton se ai është me natyrë ligjore dhe lidhet me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kundërthënie dhe të mos ketë respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton që interpretimi i ligjit të ketë qenë arbitrar e në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

35. Për sa më lart, në kushtet kur pretendimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor, të ngritura nga kërkuësja janë haptazi të pabazuara, edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për punë, i ndërvarur nga procesi, është haptazi i pabazuar.

36. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket kërkueses Migena Reçi, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3600 (299), datë 21.09.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jam kundër qëndrimit të shumicës për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi vlerësoj se kërkesa përmbush kriteret paraprake të pranueshmërisë, përfshirë legjitimitimin *ratione materiae*.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes, rezulton se me shkresën e datës 25.10.2013 ndaj kërkueses është propozuar kalimi në listëpritje, ndërsa në datën 07.01.2014 është vendosur kalimi i saj në listëpritje. Duke mos qenë dakord me këto akte administrative, kërkuësja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në rastin e kërkueses ka arsyetuar se ligji i zbatueshëm është ligji nr. 8549/1999 dhe në kushtet kur asaj nuk i është ofruar një pozicion pune i njëjtë ose i nivelit më të ulët, ajo gjykatë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Mbi ankimin e palëve, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se për mosmarrëveshjen objekt gjykimi është i zbatueshëm ligji nr.152/2013 dhe për këtë shkak kërkuësja nuk mund të nxirrej në listëpritje, pasi një koncept i tillë nuk njihej nga ky ligj. Në përfundim, gjykata e apelit ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke vendosur rikthimin e kërkueses në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e saj të mëparshëm dhe pagimin e pagës deri në ditën e rikthimit në detyrë.

3. Për rekursin e palëve të paditura në gjykim, Gjykata e Lartë, pasi është shprehur se palët kanë marrë njoftim sipas ligjit dhe nuk kanë depozituar qëndrim me shkrim përpara saj, ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta, duke vendosur rrëzimin e padisë. Sipas asaj gjykate, ligji i zbatueshëm është ai nr. 8549/1999 dhe në kushtet kur akti i kalimit në listëpritje është kryer sipas formës dhe procedurës së parashikuar nga ligji, ai nuk mund të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.

4. Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar, ndër të tjera, të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë për datën e shqyrtimit të rekursit, ndonëse në vijim i ka komunikuar përfaqësueses së saj një kopje të vendimit.

5. Lidhur me këtë pretendim, shumica ka vlerësuar se mungesa e njoftimit individual nga Gjykata e Lartë për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nuk rezulton të ketë

ndikuar në cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur të kërkueses, në kuptimin substancial, për sa kohë që ajo është njoftuar për rekursin dhe ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs. Po sipas shumicës, në rekurse janë ngritur pretendime për zbatimin e ligjit, të cilat janë debatuar nga palët në gjykatat e faktit dhe kërkuësja nuk ka treguar ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë gjatë procesit gjyqësor, i cili mund të passillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së saj nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

6. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës, sepse, në thelb, ky lloj vlerësimi i përket fazës së gjykimit të çështjes në themel dhe jo fazës së shqyrtimit paraprak, ku themeltësia e pretendimeve të kërkueses analizohet *prima facie*. Në ndryshim nga shumica, çmoj se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, për shkak të mosnjoftimit nga Gjykata e Lartë të datës së shqyrtimit të rekursit, nuk është haptazi i pabazuar, për rrjedhojë kishte vend për shqyrtimin e tij në seancë plenare. Në vijim, do të paraqes argumentet në mbështetje të qëndrimit tim.

7. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga njëra anë, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 23 datë 04.04.2024; nr. 14 datë 21.03.2023; nr. 13, datë 20.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesin në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 41, datë 18.09.2023; nr. 13, datë 12.03.2023; nr.17, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata ka pohuar se edhe njoftimi i datës dhe orës së gjykimit është një akt i domosdoshëm procedural, që merr rëndësi më tepër në rastin kur Gjykata e Lartë ka ndryshuar dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë e kërkueses. Në këtë rast, moskomunikimi i zhvillimit të seancës nga ana e administratës gjyqësore, në përputhje me rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit administrativ, sjell mospërfitimin e garancive ligjore të kërkueses për njohjen në kohë të pretendimeve të palës tjetër dhe kundërshtimin e tyre nëpërmjet paraqitjes së

argumenteve, kjo me qëllim shmangien e vënies në një pozitë të pafavorshme në raport me atë palë (*shih vendimin nr. 65, datë 07.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, nuk pajtohemi me argumentin e shumicës që ka vlerësuar se mosnjohimi i datës së shqyrtimit të rekursit është një shkelje procedurale, e cila nuk konsiderohet thelbësore, për rrjedhojë nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtën për proces të rregullt. Sikurse rezulton nga aktet, vendimi i gjykatës së apelit, i cili është i formës së prerë, ka vendosur në favor të kërkueses, duke shpallur pavlefshmërinë e aktit të kalimit në listëpritje dhe detyrimin e palës së paditur për kthimin e saj në vendin e punës dhe pagesën e pagave nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Ndonëse kërkuësja ka marrë dijëni për rekursin e palëve të paditura, nuk rezulton që ajo të ketë paraqitur kundërrkurs. Pavarësisht këtij fakti, Gjykata e Lartë pas 7 vjetësh e ka përmbysur këtë rezultat, duke rrëzuar padinë e ngritur prej saj në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

10. Për sa i përket mënyrës se si ka vepruar Gjykata e Lartë, sjell në vëmendje se me urdhrin e datës 02.07.2021 ajo ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore që, përveç afishimit në këndin e njoftimit dhe shpalljes në faqen elektronike, të kryejë edhe njoftimin elektronik në adresat e postës elektronike të palëve. Ky detyrim nuk rezulton të jetë përmbushur nga Gjykata e Lartë, ndonëse pas vendimmarrjes një kopje e vendimit i është komunikuar në adresën elektronike përfaqësueses së kërkueses.

11. Mënyra se si Gjykata e Lartë ka vepruar, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për njoftimin individualisht të kërkueses në adresën elektronike të saj ose përfaqësueses, në dukje të krijon idenë sikur ajo gjykatë ka vendosur dhe përmbysur rezultatin e çështjes në disfavor të kërkueses vetëm mbi bazën e pretendimeve të parashtruara në rekurse nga palët e tjetra. Kështu kërkueses nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej dhe të mbrohej me shkrim në lidhje me çështjen, duke iu vendosur një barrë e tepruar në këtë drejtim, për më tepër duke mbajtur në konsideratë se shqyrtimi i rekursit është bërë pas një kohe relativisht të gjatë dhe padia e saj ishte pranuar pjesërisht me një vendim gjyqësor të formë së prerë që prej vitit 2016. Në këto kushte, në vlerësimin tim, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur kërkesat për garantimin e procesit të rregullt ligjor, pasi e ka vendosur kërkuesen në pamundësi për të paraqitur pretendimet e saj, duke e vendosur në pozita të pafavorshme.

12. Në përfundim, çmoj se në kushtet kur pretendimi i kërkueses nuk duket të jetë haptazi i pabazuar, Mbledhja e Gjyqtarëve duhet të kishte vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

**Anëtare: Marsida Xhaferllari**